

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Aktiviteti 2.6.4: aktiviteti IV mbi SUT

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Søren Larsen dhe Jens Holst Jensen
Statistikat e Danimarkës

18-22 Janar 2016

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-maili

*Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 39 83
Email: shl@dst.dk*

*Jens Holst Jensen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 34 84
Email: jhj@dst.dk*

Përmbajtja

1. 1. Komentet e Përgjithshme	3
2. Vlerësimet dhe rezultatet.....	4
2.1 Kodimit i burimit të dhënave.....	4
2.2 Statistikat e ASN-së për 2013.....	5
2.3 PRODCOM statistikat për 2014.....	5
2.4 Karahasimi i burimit të dhënave për industri në total.....	5
2.5 Strukturat e produktit të outputit dhe inputit të industrisë.....	6
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	6
Aneksi 1. Termat e Referencës	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.

Lista e Shkurtesave

CPA	Klasifikimi Statistikor i Produkteve sipas Aktivitetit në Komunitetin Ekonomik Evropian
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
NACE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
PRODCOM	Lista e Produkteve në Komunitetin Evropian
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termat e Referencës

1. Komentet e përgjithshme

Ky raport mbi misionin është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është misioni i pestë, që i kushtohet përpilimit të Tabelave Ofruese-Përdoruese për vitin 2013 në kuadër të komponentit 2 të projektit, Llogarive Kombëtare. Si në misionet paraprahe, ky mision ka pasur për qëllim transformimin e burimeve të të dhënave në një format të standardizuar për tu përdorur në kornizën e tabelave ofruese përdoruese. Gjatë misioneve paraprahe janë zgjidhur shumë probleme, por akoma ka një numër për tu zgjidhur.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Të vazhdohet me kodimin dhe formatizimin e burimit të dhënave, që ka filluar në misionin e kaluar.
- Të vazhdohet punë me dy burimet e reja të të dhënave 'ASN 2013' dhe 'PRODCOM 2014', dhe të kodohen dhe formatizohen rezultatet.
- Të krijohet një version fillestar i objektivave për totalin e kolonave në tabelat e SUT, bazuar në burimet e të dhënave në dispozicion.
- Të punohet në strukturat e produktit të outputeve dhe inputeve në industri.
- Të prodhohen/azhurnohen dosjet në një rrjet kompjuterik në ASK.

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Kodimi i burimit të dhënave.

Në misionet paraprahe, janë koduar të dhënat për disa fusha dhe janë kthyer në një format të standardizuar për tu përdorur për kornizën e SUT. Të dhëna të tilla mbulojnë këto fusha:

- Bujqësi
- Statistikat e TVSH-së
- Statistikat e ASN-së për 2012
- Importet dhe Eksportet e mallrave
- Anketa e buxhetit të ekonomive familjare
- Inputi dhe outputi për qeverinë e përgjithshme si dhe strukturën e produkteve të detajuar për inputet e qeverisë.
- Taksat dhe subvencionet mbi distribuimin e produkteve sipas produkteve të definuar për SUT.

Në fillim të këtij misioni kanë qenë të gatshme statistikat e ASN-së për vitin 2013 dhe statistikat PRODCOM për vitin 2014. Megjithatë, me të dyjat ka pasur disa problem kodimi, që duhej të korrigjoheshin përpara se këto të dhëna të perdoreshin si input për SUT.

Kodimi i të dhënave nga statistikat PRODCOM për vitin 2014 dhe ASN për vitin 2013 duhet të ngriten në standardin e duhur, për tu përdorur për vendimet mbi madhësinë e objektivave për totalin e outputit dhe inputit të industrisë.

2.2 Statistikat ASN për vitin 2013.

Gjatë misionëve paraprake variablat e ASN-së janë përkthyer në koncepte, që nevojiten për qëllime të llogarive kombëtare. Gjatë këtij aktiviteti doli që kishte nevojë për validim shtesë në mënyrë që të dhënat të jenë të gatshme për përdorim. Në disa raste, korrigjimi automatik i gabimeve do të ishte i vështirë dhe duhet të bëhet në mënyrë manuale. Totalët e outputit dhe inputit të industrisë ende konsiderohen deri diku të pasigurta, por ato janë krahasuar me informatat e tjera në dispozicion nga statistikat e TVSH-së dhe kalkulimet e llogarive kombëtare aktuale para se të merren vendimet mbi vlerat që janë futur në kornizën SUT.

Është vendosur të mos përdoren informatat e detajuara mbi strukturat e produkteve nga ASN 2013, pasi shumë pak të anketuar kanë ofruar këto informata dhe duket që statistikat PRODCOM janë më të besueshme për këto struktura.

2.3 Statistikat PRODCOM për vitin 2014.

Para misionit të kaluar, këto statistika kanë pasur titujt në Gjuhën Angleze dhe outputet e industrisë janë koduar sipas CPA. Strukturat e inputit nuk janë klasifikuar në mënyrë të njëjtë sistematike dhe të dhënat tani janë koduar duke shikuar përshkrimet e inputeve në Gjuhën Shqipe. Është bërë një listë e të gjitha përshkrimeve të ndryshme (në gjuhën shqipe) të produkteve në PRODCOM. Ka pasur përshkrime të ndryshme për produktet e njëjta. ASK ka bërë pothuajse tërë kodimin e produkteve-input para se të fillojë misioni, kurse çështjet e pazgjidhura janë trajtuar gjatë misionit.

Në fillim të kodimit të PRODCOM për pjesën e inputit, është vërejtur që kodimi original i pjesës së outputit ka pasur shumë gabime përkthimi nga përshkrimet e produktit në Gjuhën Shqipe në klasifikimet CPA. Para misionit aktual është bërë një listë me përshkrime në Gjuhën Shqipe, e ngjashme me atë të përdorur për të shtuar kodet e produktit në anën e inputit. Për të lehtësuar diskutimet mbi kodimin, stafi i ASK-së ka përkthyer tekstin nga Gjuha Shqipe në Gjuhën Angleze dhe ka shtuar propozimet për kodet e produkteve. Është bërë një punë e konsiderueshme dhe kodimi mund të përfundojë gjatë këtij misioni.

Është bërë korrigjimi i kodimit të outputeve dhe inputeve në statistikat PRODCOM në nivel të produkteve të përdorura për SUT. Kjo nuk është shumë e detajuar, siç është kodimi original sipas CPA. Megjithatë, me siguri do të jetë mjaft i dobishëm në korrigjimin e kodimit për vitin 2014, kur të grumbullohen dhe kodohen statistikat e radhës PRODCOM, pasi ekziston një lidhje mirë midis mes produkteve në SUT dhe klasifikimeve sipas CPA.

2.4 Krahasimi i burimit të dhënave për totalët e industrisë.

Një pjesë e misionit i është kushtuar grumbullimit të dhënave në dispozicion mbi madhësinë e totalit të outputit dhe totalit të konsumit të ndërmjetëm për secilën industri në kornizën SUT. Janë krijuar tabelat për krahasim midis vlerave të gjetura në llogaritë kombëtare ekzistuese, statistikat e TVSH-së, statistikat e ASN-së, llogarive qeveritare dhe të dhënave të bujqësisë për vitin 2013. Vlerat po ashtu janë krahasuar me totalin e industrisë nga PRODCOM 2014, duke pasur parasysh që ato i referohen një viti tjetër. Bazuar në këto informata, janë marrë vendimet mbi objektivat e përcaktuara për vlerat e outputit dhe inputit në secilën industri. Disa përjashtime të vogla, por të rëndësishme, janë tregtia me shumicë dhe pakicë dhe ndërtimtaria, që duhet ti nënshtrohen validimit të mëtejme. Në fund, outputet dhe inputet e NPISH do të jenë çështje për trajtim gjatë misionit të radhës.

2.5 Strukturat e produktit të outputeve dhe inputeve të industrisë.

Për disa industri, struktura e produktit të outputit përcaktohet nga kalkulimet e vlerave të totalit të outputit të tyre. Për të tjerat, struktura e outputit duhet të vendoset në bazë të informatave të detajuara sipas industrive NACE katër shifror, outputi i të cilave i shtohet outputit të kornizës SUT të industrive dy shifrore. Për ato industri, që mbulohen nga PRODCOM, ne kemi informata të detajuara se si duhet të shpërndahet prodhimi sipas produkteve dhe bi-produkteve karakteristike të industrisë. Gjatë këtij misioni, matrica e anës ofruese është plotësuar pothuajse me të dhëna, me përjashtim të tregtisë, ndërtimtarisë dhe outputet e NPISH e cekura më lart. Janë grumbulluar informatat mbi inputet, por në misionin e radhës duhet të plotësohen sipas supozimeve mbi përdorimin e produkteve të vogla si dhe disa supozimeve të pasigurta në strukturën e inputeve të industrive të shërbimeve të caktuara. Tashmë janë vendosur versionet e fundit të kalkulimeve për fusha të ndryshme në rrjetin e përbashkët të zyrës, që po ashtu përmban versionin e fundit të kornizës SUT.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Është kërkuar një angazhim i madh për t'i ngritur statistikën e ASN dhe PRODCOM në nivelin e përshtatshëm për tu përdorur për përpilimin e SUT. Staf i ASK-së ka përfunduar shumicën e detyrave para misionit aktual dhe kjo e ka bërë të mundur vazhdimin e përgatitjes të inputit të dhënave gjatë këtij misioni.

Duhet të ceket që do të ishte e vështirë të përfundohet me kohë kjo punë, pa prezencën e dy personave të financuar nga SIDA. Me largimin e tyre në shkurt, llogaritë kombëtare do të humbin një pjesë të dobishme të stafit të sapotrajnuar.

Plani për finalizimin e SUT ende kërkon që shumë çështje të pazgjidhura të zgjidhen për një kohë shumë të shkurtër. Rekomandohet që, pavarësisht intervalit të shkurtër midis tyre, të mbahen dy misione në Shkurt 2016. Misioni i parë preferohet të mbahet në fillim të muajit, kurse misioni i dytë në fund të muajit, në mënyrë që të bëhen kalkulimet para balancimit final të sistemit, që duhet të bëhet në misionin e fundit.

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahja për Statistika

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.6.4: SUT aktiviteti IV.

Vazhdim i përkrahjes në përpilimin e llogarive kombëtare në Kosovë, me fokus në tabelat ofruese përdoruese

Orari:

TeR –data e përgatitjes: 4 Janar 2016

Fillimi / fundi i aktivitetit: 18-22 Janar 2016

Koha e raportimit: 5 Shkurt 2016

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ	Intervenimi logjik	Pikë referimi	Burimi i informacionit	Sugjerimet
2.3.1	Përkrahje në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raportet e misioneve, të publikuar në faqen e internetit të projektit - Fushat e caktuara të Llogarive Kombëtare, të përditësuara sipas ESA2010	- Raportet tremujore të projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i përditësuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e dytrave, që lidhen me projektin në mes të misioneve - Qasje në statistikat primare të sakta - Termat e referencës, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat,

				rezultatet e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.6.4

Përkrahja në përpilimin e Llogarive Kombëtare në Kosovë. Fokus në Tabelat ofruese-përdoruese (SUT). Ky mision është vazhdimësi e misionit me Z. Søren Larsen, Jens Holst Jensen 2.6.2, dhe misionit 2.6.3 të Maria Nilsson në Dhjetor 2015. Misioni në Dhejtor ka konkluduar që:

Gjatë aktiviteti 2.6.3 të dhënat e qeverisë së përgjithshme janë sjellë në fazën, ku të dhënat e inputit dhe outputit janë koduar sipas produkteve dhe industrive dhe vlerat janë futur në Excel në kornizën SUT. Të dhënat e azhurnuara për qeverinë e përgjithshme janë në dispozicion dhe do të kodohen dhe futen në kornizën SUT, nga stafi i ASK-së, pas misionit. Puna në ASN dhe PRODCOM nuk do të mund të përfundohet dhe nevojitet të vazhdohet gjatë kohës deri në misionin e radhës. Pasi të largohen një numër i konsiderueshëm gabimesh nga të dhënat e ASN-së do të jetë (në kombinim me statistikën e TVSH-së) burimi kryesor për totalin e outputit dhe inputit për ato industri, që mbulohen me këto statistika. Të dhënat e detajuara të industrisë për tregti do të përdoren për të vendosur shpërndarjen e marzhave të tregtisë sipas produkteve. Statistikat e TVSH-së do të krijojnë bazën për shpërndarjen e TVSH-së së pazbritshme sipas produkteve dhe industrive.

Gjatë misionit, stafi i ASK-së e ka theksuar që duhet të azhurnohen disa inpute në kalkulimet fillestare. Një shembull janë të dhënat e lartpërmendura nga llogaritë qeveritare. Po ashtu, është shprehur dëshira të përmirësohet metoda e përdorur për grumbullimin e të dhënave nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare. Përmirësime të tilla është e preferueshme të implementohen në tërësi, para misionit të radhës, pasi është e rëndësishme të ecet përpara me procesin e popullimit të kornizës së SUT. Po ashtu, në këtë moment duhet të mbahet në mend që detyra më e rëndësishme është kodimi i inputit PRODCOM dhe korrigjimi i gabimeve në ASN për vitin 2013.

Duke vënë së bashkë të gjitha informatat mbi outputet, inputet dhe përdorimin final si dhe të shpërndarjes së marzhave të tregtisë, taksat dhe TVSH-ja duhet të presin që të jenë të gatshme të dhënat-inputet e fundit. Balancimi i anës ofruese dhe përdoruese nuk mund të bëhet para se të popullohet tërësisht me të dhëna korniza e SUT. Pasi disa misione janë vonuar për arsye të mungesës të burimeve të të dhënave të rëndësishme, rekomandohet të mbahen tre misione gjatë muajit Janar dhe Shkurt të vitit 2016.

Planet që nevojiten për misionin në vijim

Veprimi	Afati kohor	Personat përgjegjës
Kodimi dhe formatizimi i të dhënave ASN 2013.	Para misionit të radhës	Ekspertët danezë: Korrigjimi automatik i gabimeve ku është e mundur. Stafi i ASK-së: Gabimet e mbetura.
Kodimi i PRODCOM 2014.	Para misionit të radhës	

		<i>Stafi i ASK-së: Korrigjimi i gabimeve në kodimin e outputeve të industrisë. Kodimi i inputeve bazuar në përshkrimin e produkteve në Gjuhën Shqipe</i>
--	--	--

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.6.4:

Raporti i misionit, që përshkruan rezultatet e kodimit të dhënave, që do të përdoren për SUT

Rekomandimet për SUT në të ardhmen në ASK

Përshkrimi i punës së bërë gjatë misionit dhe punës që duhet bërë para fillimit të aktiviteti të radhës

Stafi i ASK-së:

Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevrie.Fetahu@rksgov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krap, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krap@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive

Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Z. Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk

Z. Jens Holst Jensen, Këshilltar i Lartë, jhj@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente e RTA, nzogaj@yahoo.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA), i përgatitur nga Eurostat-i, deklaron në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK-ja, me mbështetjen e IPA-s, ka përgatitur një 'Plan të veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërshirëse për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare, së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

Projekti i Binjakëzimit deri tani ka pasur disa aktivitete në Komponentin #2 Llogaritë Kombëtare përfshirë misionin e gjetjes së fakteve mbi SUT

Aktivitetet, që duhet të ndërmerren në përgatitje të misionit:

- Raportet e misionëve të kaluara në komponentin e LLK. Të gjitha të publikuara në www.dst.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për përmirësimin e Llogarive Kombëtare me SUT
- Zhvillimi i planit të detajuar për veprimet e ardhshme mbi SUT nga programi i binjakëzimit
- Kodimi i të dhënave

Rezultatet e pritura janë:

- Raporti i misionit – sipas modelit
- Plani i detajuar për aktivitetet e mëtejme në komponentin 2 nga programi i binjakëzimit
- Versioni i azhurnuar i planit për SUT
- Lista e veprimeve që duhet të ndërmerren para misionit të ardhshëm

Aneksi 1. Programi, Janar 2016

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	ASK: Rishikim i punës së bërë nga misioni i kaluar mbi SUT në Tetor 2015
		10:45	Pushim për kafe
		11:00	Diskutimi mbi planet për këtë javë
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Punë praktike me të dhënat për SUT
2	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
3	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT
4	ASK	09:00-16:00	Punë praktike me të dhënat për SUT Diskutimi mbi rekomandimet Plani për misionin e ardhshëm dhe si të veprohet para misionit të radhës Shkrimi i raportit
5	ASK	10:00-12:00	Shkrimi i raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

